REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 70/17
Datë/Datum. 06.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

PSH Nr. 70/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Goran Milenković - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, - z.Blerim Dina Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Er-Lis&Ve-Mor"- Prishtinë, kundër vendimit per dhënie të kontrates të AK–/Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr. prokurimi:"KEKO/16/145/221", më datën 03.04.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "Er-Lis&Ve-Mor" - Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr prok:"KEKO/16/145/221", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontrates i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës sh.a/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr. prokurimit:"KEKO/16/145/221" si i pa bazuar dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**, me qëllim që konform nenit 72 të LPP-së të kërkohen informata sqaruese shtesë në lidhje me ofertën e OE ankues.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE "Er-Lis&Ve-Mor" – Pejë, lidhur me aktivietin e prokurimit me titull "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr. prokurimit:"KEKO/16/145/221", konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar si e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues-KEK ka bërë shpalljen e Njoftimit për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit me dt:.29.11.2016.

Dorëzimi dhe Hapja e ofertave është bërë me dt: 22.12.2016, ku kanë marr pjesë katër operatorë ekonomik.

AK-KEK me dt. 04.01.2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3(tre) antarëve te cilet kanë filluar dhe mbaruar vlerësimin me dt.26.01.2017.

Njoftimi për dhënje te kontrates lidhur me aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë me dt:21.02.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "KASTRATI-L" - Gllogovc.

Kundër njoftimit për dhënje te kontrates lidhur me aktivitetin e prokurimit ne fjalë, operatori ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor" - Pejë, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor" - Pejë, për rishqyrtim të njoftimit për dhënje te kontrates Autoriteti Kontraktues me dt:01.03.2017 ka marr vendim me te cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Operatori ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor" - Pejë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më dt.09 mars 2017 me nr. 70/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr prok:"KEKO/16/145/221", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së –Qëllimi
- Neni 6 i LPP-së –Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, me dt.14.03.2017 ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 24 mars 2017, propozon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit me titull "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr. prok:"KEKO/16/145/221" iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, të kthehet në Rivlerësim, ndërsa ankesen e operatorit ekonomik "Er-Lis&Ve-Mor" - Pejë të aprovojë si të bazuar.
Autoriteti Kontraktues me datë: 28 mars 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03.04.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Er-Lis&Ve-Mor" ka deklaruar se: "Ne qëndrojmë në tërësi pranë gjitha pretendimeve tona ankimore të parashtruara në ankesë, dhe po ashtu pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues si dhe ne si OE i plotësojmë në tërësi të gjitha kërkesate /kriteret e parashtruara në dosje dhe në FDT.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesit e AK-KEK kanë deklaruar: "Fillimisht se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat sipas dosjes për pajisjet, që janë shumë me rëndësi, dhe i njëjti ka ofruar referenca për pastrime të kanalizimeve, ku vet ka cek se ka referenca të mishtores, birrarisë së Pejsë, e këto nuk janë industriale.
Sa i përket pjesës teknike të prodhimit gjegjsisht specifikimit teknik perfaqsusi i AK-KEK inxhinier përgjegjës për sistemin e kanakzikeve në TCB, sistemin e hidrenatve dhe një mori segemteesh tjera deklaron se me kujdes është shqyrtuar qoftë fillimi i hapjes së parë, qoftë procesi ankimorë në shqyrtim të kërkesës së OE.
Inxhinjeri në fjalë me qëllim sqarimi ceku se egzistojn tri lloje të kanalizimeve në TCB te cilat janë: Fekale, të shiut dhe të kracerit.

Procesi teknologjik është pjesa e kazanit që hiri i atij kazani që përdoret si material lidhës në Elez Han, është problematika kryesore e krejt kësaj procedure.
Sa i përket pastrimeve të kalaizmeve fekale etj, OE pltoëson kushtet, mirëpo për Kracer vetëm termocentralet kanë specifikë të veçante, si dhe vetëm Trepca mund ti afrohet si i industri e rëndë termocentraleve.
Afiniteti lidhës i mateirlaeve të kazanit e bënë që shumë kohe e shkrut duhet që materiali të ngurtësohet, aty janë afër 500 metra gyp F400 dhe afër 30 metra F1000. Ky material duhet mjete realisht speciale, përveç që kërkohet autociseterna me shtypje 250bar, ajo duhet te posedoj jo diza të thjeshta siç ka prezantuar OE ankues mirëpo duhet të jenë diza tjera rotative, rotative me zinxhir ashtu si janë kërkuar me dosje të tenderit.
Përveç kësaj duhet të posedoj edhe Iriqët, mirëpo kjo nuk është prezantuar mënyra kryerjes së punëve, dhe nuk ka prezantuar iriqët.
Ky aktivitet ka filluar në vitin 2015 dhe e kemi anuluar për shkak të çmimeve të larta, dhe ruajtjes së buxhetit. Po ashtu ofertues që nuk janë serioz dhe nuk e kuptojnë vëllimin e punëve që është në atë pjesë.
Ne kemi pas raste ku OE-të kanë ofruar teknologji amerikane mirëpo cmimi ka qenë marramendës.

Ne fjalen e saj në seancë ekspertja shqyrtuese ka deklaruar: "Se sa i përket pretendimit ankimorë lidhur me arsyet e eliminimit për referenca, sqaroj se AK në FTD te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale ka specifikuar që "OE-të duhet të dorëzojnë projektet e realizuar brenda tri viteve të fundit" kurse si dëshmi dokumentare është kërkuar "të prezantohet një referencë për punë të ngjashme në objektet industriale, në tri vitet fundit ku mund te shihet përvoja e punës".

Lidhur me kërkesën në fjalë OE ankues ka ofruar dëshmi referencë të lëshuar nga kompania Buquku në Pejë, pastaj referencën nga Birra Pejës, ku specifikohet se ka kryer punët me sukses anëtari VeMor.

Në rastin konkret AK nuk ka specifikaur që këto referenca të jenë për objekte energjetike, andaj në rastin konkret i kamë vlerësuar si referenca konform kërkesës së AK.

Ndërsa sa i përket çështjes së makinerisë speciale për pastrimin e kanalizimeve, që OE pretendon se plotëson kërkesat e AK-së, OE ankues në rastin konkret ka ofruar deklaratën se pajtohet me gjitha specifikat teknike në Aneksi 1, pastaj listën e makinerisë, ka dy certifikata të regjistrimit të automjeteve për pastrim të kanalizimeve dhe larje të rrugëve, si dhe ka bashkangjitur fotografitë e pajisjeve.
Me qenë se diferenca në çmim mes OE ankues dhe atij të rekomanduar është bukur e lartë, si dhe duke pas parasysh se është ofruar lista makinerisë kam propozuar që lënda të kthehet në rivlerësim konform neni 72 që edhe njëherë ti ofrohet mundësia OE ankues të dëshmoj se plotëson këto pajisje.

Edhe një her potencoj se arsye kryesore është dallimi në çmim shumë i lart mes OE ankues dhe atij të rekomanduar për kontratë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: "Specifikat e dosjes si herën e parë para ritenderimit, si tani janë të njëjta 100%.
Në afat ligjorë kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente dhe nuk na është lejuar, dhe kemi dëshmi për kërkesën tonë dhe nuk kemi pranuar as përgjigje nga AK.
Ne qëndrojmë në tërësi pranë pretendimeve ankimore dhe kërkojmë që lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe AK mundet në çdo kohë të bëjë vizitë për shikimin e makinerisë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-KEK deklaroj "Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit shqyrtues të vërtetoj të njëjtin si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare ekspertja shqyrtuese deklaroj:"Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë".

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së AK-së, deklarimit te OE ankuese ne seanc lidhur me ekspertizen, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se AK-KEK me rastin e vlersimit te ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave te kracerit" me nr. prokurimit:"KEKO/16/145/221" nuk i ka respektuar nenet 6, 59, 60 dhe 72 të LPP-së. Prandaj obligohet AK-së që konform nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me dokumentacionin teknik (për paisje) të cisternave me pjesë përcjellëse për depertim të kanalizimeve katalog ose fotografi të paisjeve.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE – "Er-Lis&Ve-Mor" - Pejë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.